



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2024

V E N D I M

Nr. 61, datë 07.02.2024

PËR

PEZULLIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATES {...}, ME FUNSKION GJYQTARE PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, më datë 07.02.2024, pasi u njoh me informacionin e ardhur, me shkresën nr. 3147 prot., datë 07.02.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për pezullimin nga detyra të magjistrates znj. {...}, përgatitur nga Komisioni Disiplinor,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Më datë 07.02.2024, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, është depozituar shkresa nr. 3147 prot., datë 07.02.2024 e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe materiali bashkëlidhur.

1.1 Nga përmbajtja e materialit të ardhur me shkresën nr. 3147 prot., datë 07.02.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se është regjistruar procedimi penal nr. 552 viti 2024, për veprën penale “Kanosja e gjyqtarit” parashikuar nga neni 317 i K.Penal, pas kallzimit të bërë nga shtetësja, magjistratja {...}, me datë 20.01.2024 pranë Komisarariatit të Policisë nr. 3 Tiranë.

1.2 Pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprahe, administrimit të aktit të ekspertimit grafik shkrimi, ka rezultuar se magjistratja {...}, është marrë në cilësinë e të pandehurës nën akuzën e veprave penale “Kallzim i rremë” dhe “Falsifikimi i dokumentave” të parashikuara nga nenet 305, 186/1 të K.Penal.

2. Sa sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin e datës 07.02.2024 ka vendosur marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës.

3. Rezulton se e pandehura {...}, aktualisht gëzon statusin e magjistratit dhe ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

4. Në përmbushje të detyrimit ligjor, të parashikuar nga neni 151, pika 3 të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është kryer njoftimi për Këshillin e Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 3147 prot., datë 07.02.2024, protokolluar në Këshill me nr. 879 akti, datë 07.02.2024.

II. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

5. Në nenin 140, pika 3, shkronja b) e Kushtetutës së Shqipërisë parashikohet shprehimisht: **“Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje; c) kur fillon procedimi disiplinor, sipas ligjit... ”**

6. Rastet e pezullimit të magjistratit për shkak të ligjit parashikohen në nenin 151 të Ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si vijon: **“1. Magjistrati pezullohet nga detyra me vendim të Këshillit përkatës kur: a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi” për kryerjen e një veprë penale; b) ai merr cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje. 2. Pezullimi, sipas pikës 1, të këtij neni zgjat: a) gjatë periudhës së arrestit me burg ose arrestit në shtëpi, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “a” të këtij neni; b) deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, në rastin e parashikuar në pikën 1, shkronja “b” të këtij neni. 3. Kryetarët e gjykatave dhe të prokurorive, të cilët marrin vendimet përkatëse, detyrohen të njoftojnë Këshillin për faktet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli, menjëherë pasi merr informacionet nga prokuroria ose gjykata, vendos pezullimin për shkak të ligjit të magjistratit.”**

7. Ndërsa, neni 155 i Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon vendimet e pezullimit dhe ankimet: “1. Vendimi për pezullimin nga detyra, sipas parashikimit të neneve 151 dhe 152, të këtij ligji, merret nga Këshilli brenda **tre ditëve pas paraqitjes së kërkesës ose informacionit**. 2. Magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në gjykatën kompetente. 3. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vendimin për pezullimin nga detyra të magjistratit.”

III. VLERËSIMI I KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

8. Referuar informacionit të ardhur me shkresën nr. 3147 prot., datë 07.02.2024 nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se me datë 20.01.2024 është bërë kallzim penal nga shtetësja/magjistratja {...}, pranë Komisarariatit të Policisë nr. 3 Tiranë.

8.1 Në kallzimin e saj, magjistratja {...}, ka deklaruar se ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Dhoma Penale. Me datë 20.01.2024, rreth orës 11.00, tek ka qenë në zyrën e saj, në katin e tretë të godinës, nr. 321, pasi është kthyer nga gjykimet, ka konstatuar në tavolinën e saj të punës, mbi dosje, një zarf dhe brenda tij një letër, e cila në përmbajtjen e saj kishte kërcënim me jetë, për të dhe familjarët e saj. Letra është futur në kasafortë prej saj dhe ajo është ndjerë e frikësuar....

9. Pas kallzimit të bërë me datë 20.01.2024, nga shtetësja/magjistratja {...}, materiali kallzues ka kaluar për veprim pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila ka vlerësuar dhe ka regjistruar procedimin penal nr. 552 viti 2024, për veprën penale “Kanosja e gjyqtarit” parashikuar nga neni 317 i K.Penal, duke urdhëruar dhe kryerjen e veprimeve të para hetimore.

10. Në vijim, pas kryerjes së veprimeve hetimore paraprahe, ndër ta dhe administrimit të aktit të ekspertimit grafik shkrimi, me vendimin e datës 07.02.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka rezultuar se magjistratja {...}, është marrë në cilësinë e të pandehurës nën akuzën e veprave penale “Kallzim i rremë” dhe “Falsifikimi i dokumentave” të parashikuara nga nenet 305, 186/1 të K.Penal.

11. Rezulton, si dhe nga të dhënat që disponon Këshilli i Lartë Gjyqësor, e pandehura {...}, aktualisht gëzon statusin e magjistratit dhe ushtron funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

12. Sa sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se ndodhet para një prej rasteve të pezullimit të detyruar apo për shkak të ligjit të magjistratit, sipas parashikimeve të nenit 140, pika 3, shkronja “b” të Kushtetutës dhe nenit 151, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016, “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duke arritur në përfundimin se ndaj magjistrates {...}, e cila ushtron funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duhet të vendoset masa e pezullimit nga detyra për shkak të ligjit, për arsye të plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara nga neni 151, pika 1, shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi magjistratja akuzohet për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 305, 186/1 të K.Penal, ka marrë cilësinë e të pandehurit për një krim të rëndë të kryer me dashje.

13. Lidhur me kohëzgjatjen e pezullimit të magjistrates nga detyra, Këshilli vlerëson se ky pezullim do të vazhdojë deri në pushimin e çështjes penale ose në dhënien e një vendimi të formës së prerë, sipas parashikimeve të nenit 151, pika 2, shkronja “b” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

14. Ndërsa, lidhur me të drejtën e ankimit, referuar nenit 155, pika 2 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 100 të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli vëren se, magjistrati ka të drejtë të ankimojë vendimin për pezullimin nga detyra në gjykatën kompetente, konkretisht në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 140 pika 3, gërma b), dhe nenin 147/a, pika 1, gërma b) të Kushtetutës, në nenin 61, pika 2, gërma b), në nenin 97, pika 1, gërma a) të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 151, pika 1, gërma b) dhe 155 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Pezullimin nga detyra të magjistrates {...}, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet magistrates {...}, sipas kërkesave të nenit 98, pika 1 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, si dhe bëhet publike në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR